

**DEKLARATË E ZAHIR TANIN, PËRFAQËSUES SPECIAL I  
SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM DHE SHEF I UNMIK-UT  
DEBATI I KËSHILLIT TË SIGURIMIT PËR UNMIK-UN  
NJU JORK  
14 MAJ 2018**

Zonja presidente, të nderuar anëtarë të Këshillit,

Siç është pasqyruar në raportin e Sekretarit të Përgjithshëm, periudha e kaluar në Kosovë në përgjithësi është karakterizuar me rënie si të cilësisë së aktiviteteve, ashtu edhe të dinamikës së diskursit politik mes Prishtinës dhe Beogradit. Në mars janë mbajtur takime orientuese, por të rëndësishme të dialogut të mbështetur nga BE-ja, në nivelin teknik dhe në atë politik. Kjo atmosferë pune është lëkundur kur Marko Gjuriq, drejtori i Zyrës së Serbisë për Kosovë dhe kryenegociatori i Beogradit në dialogun e mbështetur nga BE-ja, u arrestua pasi që përkundër këshillës së autoriteteve të Kosovës hyri në Kosovën e veriut për të marrë pjesë në sesionin e dialogut të brendshëm të kryetarit Alleksandar Vuçiq. Gjatë arrestimit janë përdorur granata imobilizuese, gaz lotsjellës dhe forcë fizike që kanë rezultuar me një numër lëndimesh, duke përfshirë lëndime edhe të ministrit të qeverisë së Kosovës, dy udhëheqësve komunalë, gazetarëve dhe të pjesëmarrësve të tjerë. z. Gjuriq më pastaj është parakaluar në mënyrë teatrale dhe jo të duhur në një rrugë të Prishtinës para se të dëbohej nga Kosova. Shumë serbë të Kosovës që tanimë janë të shqetësuar nga vrasja e pazgjidhur e Olliver Ivanoviqit që ndodhi në janar në Mitrovicë, kanë perceptuar këto ngjarje me frikë.

Pas këtij incidenti, figurat politike nga të dyja palët u aktivizuan në përshkallëzime të retorikës, gjë që çoi në ngecje të tjera në përpjekjet për vazhdimin e dialogut të mbështetur nga BE-ja. Grupi i deputetëve serbë të

Kosovës, të mbledhur rreth Listës Serbe, shpalli planet e tij për tërheqje nga koalicioni qeveritar i Prishtinës. Për më tepër, ata deklaruan qëllimin e tyre për shpallje të njëanshme të asociacionit/bashkësisë së komunave serbe, duke caktuar afatin e 20 prillit, i cili më pas megjithatë është tërhequr. Cilido faktor të ketë nxitur ngacmimet e ndërsjella, rezultati i tyre dukej se do të çonte qeverinë e Kosovës buzë rënies. Ujërat u qetësuan vetëm pas aktiviteteve intensive, duke përfshirë edhe përkrahjen e disa palëve të jashtme. Në këtë aspekt më të rëndësishme kanë qenë përpjekjet domethënëse të kryeministrit Ramush Haradinaj dhe të qeverisë së tij, duke përfshirë edhe diskutimet e gjata me Listën Serbe, me pjesët e tjera të koalicionit dhe me opozitën, të cilat kanë ndihmuar që kanalet e komunikimit të mbesin të hapura.

Zonja presidente,

Gjatë shumë muajve të kaluar ka pasur diskutime për perspektiven e ndryshimit të pozitive të ngrira të të dyja palëve përmes fokusimit të ri të BE-së në dialogun mes Prishtinës dhe Beogradit, si dhe përmes angazhimit më të gjerë regjional. Përkundër këtyre pritjeve, temperaturat politike në ngritje të kohëve të fundit kanë krijuar pengesa në avancimin e dialogut që kërkon vullnet të mjaftueshëm politik nga secila palë për të hyrë në nivel të ri të angazhimit dhe të dinamizimit të procesit. Alternativë tjetër të realizueshme nuk ka. Megjithatë, në mënyrë që kjo të ndodh, ekziston nevojë e qartë e lidershit për përballimin e sfidave, edhe nëse të njëjtat kanë kosto afatshkurtër politike. Fokusi i ri i Brukselit në të gjitha nivelet ofron mundësi dobiprurëse të ndërsjellë si për Prishtinën, ashtu edhe për Beogradin për ta lënë prapa momentin e tanishëm të vështirë dhe për ta çuar dialogun në fazë të re të përparimit të mirëfilltë. Për më tepër, shtetet anëtare të Bashkimit Evropian kanë caktuar një orar ambicioz për regjionin, duke përfshirë edhe mbajtjen e samitit të BE-së për Ballkanin Perëndimor në Sofje më

vonë gjatë këtij muaji, samit ky më i nivelit më të lartë regjional që nga viti 2003. Takimi i ardhshëm shumë i rëndësishëm i forumit ekonomik të Procesit të Berlinit në korrik dhe nismat e tjera të shumta do të angazhojnë Ballkanin këtë vit në mënyrë më intensive dhe do të jenë ndihmesë shtesë në bashkërendimin e aktiviteteve të ndryshme e në shfrytëzimin e përkushtimit të ri.

Zonja presidente,

Pavarësisht se garancitë e nivelit më të lartë politik mbesin thelbësore, përkushtimet e dhëna gjatë negociatave nuk kanë gjasa të jetësohen pa ndonjë nxitje të besimit mes komuniteteve dhe individëve në nivelin bazë. Për të krijuar një atmosferë të arritjes së kompromisit të arsyeshëm dhe të vullnetit të mirë, nevojitet angazhim në të gjitha nivelet që mbetet edhe prioriteti kryesor i Misionit. Kam kënaqësinë të njoftoj Këshillin se sapo kam ardhur nga Forumi i Kombeve të Bashkuara për ndërtimin e besimit në Kosovë, të cilin e hapa së bashku me Ndihmësekretaren e Përgjithshme, Bintou Keita. Në këtë Forum që u mbajt prej datës 6 deri më 8 maj në Lubjanë të Sllovenisë kanë marrë pjesë Ekipi i OKB-së në Kosovë, Bashkimi Evropian, EULEX-i, dhe OSBE-ja. Këtu u bashkuan më shumë se 100 udhëheqës të komuniteteve nga mbarë Kosova për të diskutuar mënyrat e trajtimit të sfidave të përbashkëta, të shkaktuara nga mosbesimi dhe qasjet e dobëta politike tash e njëzet vite pas kulminimit të konfliktit.

Pikënisja e Forumit ka qenë e thjeshtë, gjegjësisht të mos rizbulohen apo riinterpretohen ngjarjet nga e kaluara, por të përndritet, drejtohet dhe të ndiqet një rrugë më pozitive për të ardhmen. Individë të motivuar dhe energjikë nga e tërë shoqëria e Kosovës kanë diskutuar perspektivën e ndërtimit të besimit përmes një vistri të gjerë të aktiviteteve dhe bashkëpunimit pozitiv. Fushat kryesore tematike

kanë qenë: llogaridhënia e mediave, qasja në drejtësi të paanshme, zhvillimi ekonomik, qasja në shërbime publike, bashkëjetesa fetare dhe reforma e arsimit. Disa grupe punuese kanë punuar në fuqizimin e mirëkuptimit lidhur me ndasitë e komuniteteve. Rekomandimet e identifikuar nga pjesëmarrësit paraqesin udhëzues për zbatimin e objektivave në Kosovë. Ndhmëssekretarja e përgjithshme Keita theksoi se Forumi ishte një përpjekje proaktive e çuarjes përpara të agjendës së paqes, e angazhimit në parandalim nga niveli lokal, si dhe e lidhjes së kornizave politike me ato zhvillimore. Unë i nxita të gjithë udhëheqësit që ta organizojnë të ardhmen dhe jo ta vajtojnë të kaluarën, si dhe të ecin përpara me më shumë bashkëndjenjë, mirëkuptim dhe qartësi në avancimin e besimit në fushat e punës që i identifikuan gjatë Forumit.

Zonja presidente,

Kuvendi i Kosovës e ratifikoi marrëveshjen e vitit 2015 për shënimin e vijës kufitare me Malin e Zi, që është e rëndësishme për perspektivën evropiane të Kosovës. Për një kohë të gjatë, kjo çështje është veçuar nga Bashkimi Evropian si një hap i domosdoshëm për integrimin e Kosovës në këtë Union, duke përfshirë edhe liberalizimin e vizave. Ndonëse bashkësia ndërkombëtare e ka përshëndet këtë të arritur, është potencuar se fuqizimi i sundimit të ligjit dhe të drejtat e njeriut, si dhe përparimi i dukshëm në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, mbetin çështje të rëndësishme në përmbushjen e aspiratave të popullit të Kosovës për perspektivën e tyre evropiane. Është me rëndësi të përshëndetet edhe miratimi i projektit të ri të Kodit Penal të Kosovës, që përfshin dënime më të ashpra për veprat që lidhen me korrupsionin dhe keqpërdorimin e pozitës zyrtare. Kjo iniciativë pozitive plotëson përpjekjet e vazhdueshme në depolitizimin dhe avancimin e punës së gjyqësorit. Ne po ashtu e ndajmë me ju

analizën e paraqitur tash së voni në raportin vjetor të progresit të Komisionit Evropian për zbatimin efektiv të të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit në Kosovë. Në këtë kontekst institucionet e Kosovës për sundimin e ligjit vazhdojnë të jenë fokusi kryesor i vëmendjes së brendshme dhe të jashtme, meqë Misioni i EULEX-it bën përgatitjet për një rikonfigurim të madh, duke u transferuar gjykatave të Kosovës përgjegjësi të drejtpërdrejta për lëndët, të cilat deri tani janë trajtuar me EULEX-in në krye.

Lidhur me mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, kam kënaqësinë të theksoj se Këshilli për Implementim dhe Monitorim (KIM), i ngarkuar për mbikëqyrjen e trajtimit të zonave të mbrojtura speciale rreth objekteve religjioze, e rifilloi punën e tij. Ky zhvillim ka ndodhur në kohën e duhur, meqë kohët e fundit ka pas përpjekje për mosrespektim të aktgjykimit të gjykatave të Kosovës, si dhe të KIM, lidhur me ndërtimet në afërsi të Manastirit të Deçanit në perëndim të Kosovës. Bashkësia ndërkombëtare do të vazhdojë të vëzhgojë së afërmi veprimet e qeverisë së Kosovës për këtë rast.

Zonja presidente,

UNMIK-u vazhdon të prioritetizojë punën e tij në fushën e ndërtimit të besimit, të drejtave të njeriut, dhe të përkrahjes së kufizuar, por esenciale për sundimin e ligjit dhe institucionet e drejtësisë. Kruciale për punën e Misionit janë implementimi i agjendës për gratë, paqen dhe sigurinë si dhe për rininë, paqen dhe sigurinë.

Më 5 mars, ky Mision bashkëdrejtoi me UN Women Ditën e Hapur Globale 2018 të Kombeve të Bashkuara në Kosovë për Gratë, Paqen dhe Sigurinë. E fokusuar në pjesëmarrjen politike të grave, kjo ngjarje mbledhi më shumë se 150

lidere politike gra nga niveli qendror dhe lokal, parlamentarë dhe zyrtarë qeveritarë, përfaqësues të bashkësisë ndërkombëtare, të shoqërisë civile, të akademisë, organizatave të grave dhe aktivistë të rinisë. Në Ditën e Hapur Globale u pa nevoja për pjesëmarrjen e plotë dhe të efektshme të grave në lidërsip në të gjitha nivelet e vendimmarrjes në jetën politike, ekonomike dhe publike. Gjithashtu u theksua fakti se pjesëmarrja politike e grave është e domosdoshme për barazi gjinore në mënyrë që t'i jepet fund pabarazisë, vartësisë, statusit hierarkik dhe asimetrisë së fuqisë politike. Kjo ngjarje ishte qendrore për Strategjinë kornizë gjinore të Misionit të miratuar rishtaz, dhe ishte pjesë e një sërë iniciativash të tjera të rëndësishme në mbarë Kosovën në shenjë të Ditës Ndërkombëtare të Gruas.

Agjenda e rinisë, paqes dhe sigurisë është po ashtu e një rëndësie të madhe për UNMIK-un. Kah fundi i kësaj jave, ky Mision, në bashkëpunim të ngushtë me UNICEF-in dhe UNDP-në, do të drejtojnë Asamblenë e dytë të Rinisë të Kombeve të Bashkuara në Kosovë. Kjo ngjarje do të mbledhë 180 liderë të ri të profesioneve të ndryshme, duke përfshirë zyrtarë, organizata qytetare dhe udhëheqës biznesesh.

Zonja presidente,

Në fushat shumëdimensionale të punës së riorganizuar të Misionit, UNMIK-u punon në harmoni të plotë me parimet themelore të agjendës për reforma të Sekretarit të Përgjithshëm Guterres dhe me udhëzuesin e këtij Këshilli. Përpjekjet tona synojnë ruajtjen e paqes, sigurimin që të mbetemi në krye të monitorimit dhe analizimit të situatës, dhe rifuqizimin e koordinimit strategjik me pjesëtarët e agjencive të OKB-së, si dhe me partnerët ndërkombëtarë në plotësimin e punës së institucioneve të Kosovës. I falënderoj anëtarët e Këshillit

për mbështetjen e tyre të vazhdueshme të punës sonë dhe për përkrahjen e tyre në dialogun e drejtuar nga BE-ja që synon normalizimin e marrëdhënieve dhe rritjen e bashkëpunimit në mes të Prishtinës dhe Beogradit.